



Pranuar / Dorezuar Prilapto/Prilato Received/Delivry	18.04.2023	viti god year	3
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shfaqje e Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SHMESH/14	3656/2023		113



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.444/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, me Flakron Gashi Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas ankesës më numër A.nr.444/2023 të datës 01.03.2023 të parashtruar nga ankueset .

... cilat me autorizim i përfaqëson Besa Berisha, kundër organit të punësimit/Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në çështjen juridike “kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 14.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *shpallet jo kompetent* për të vendosur lidhur më ankesën A.nr.444/2023 të datës 01.03.2023 të parashtruar nga ankueset

II. Lënda i dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent/Inspektoratit të Punës.

A r s y e t i m

Ankueset ... me datë 01.03.2023 kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është e regjistruar nën shenjen A.nr.444/2023 dhe me numër të protokollit: 2235/2022, për shkak të mos përmbushjeve të kushteve elementare në punë nga institucioni punëdhënës.

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se ankueset, gjegjësisht ankuesja ... sipas ndryshimit dhe plotësimit aktit të emërimit të datës 05.12.2018 mbanë pozitën “Zyrtare e Lartë e Personelit”, ankuesja ... sipas aktit të emërimit të datës 30.01.2012 mbanë pozitën “Udhëheqëse e Divizionit të Personelit” dhe ankuesja ... sipas aktit të emërimit të datës 09.09.2019 mbanë pozitën “Zyrtare e Personelit 2” që të gjitha në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, që tani e tutje do t’i referohemi MINT.

Ankueset para se të parashtronin ankesë në Këshill me datë 19.01.2023 i janë drejtuar me kërkesë Sekretarit të Përgjithshëm të MINT për përmirësimin e kushteve të punës në kuadër të zyrës së Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, me arsyetimin se zyra në të cilën punojnë dhe veprojnë ankueset nuk ka kushte elementare në punë sikurse i mungon ajrosja, hapësira e vogël e veprimt, mungesë e dritareve si dhe mungesa e hapësirës që ndërlidhet me punët dhe veprimet konfidencialitet sikurse që janë dosjet e personelit, shtuar faktin kësaj që ankueset pretendojnë se në këto kushte të punës ka të punësuar edhe me sëmundje kronike (që kanë kaluar kancerin, anemi dhe probleme të tjera shëndetësore), sikurse që të njëjtën kërkesë ia kanë përsëritë Sekretarit të Përgjithshëm edhe me datë 02.02.2023 mirëpo nuk kanë marr asnjë përgjigje që zgjidh kërkesën e tyre.

Me qëllim të shqyrtimit të kompetencës lëndorë lidhur me ankesën e ankueseve dhe pretendimeve të tyre ankimore, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e Ligji Nr. 04/L-161 Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë nenin 1 paragrafi 1 dhe nenin 2 paragrafi 1 ku përcaktohet se: "1.1 Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i masave për përmirësimin e shkallës së sigurisë dhe shëndetit të të punësuarve në punë; 2.1 Dispozitat e këtij ligji zbatohen në sektorin publik, privat, publiko-privat dhe sektorin e administratës shtetërore të nivelit qendror dhe lokal" ndërlidhur me nenin 2 dhe 3 të Ligji Nr. 03/L-017 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës Nr. 2002/9 ku përcaktohet se: "2. Me këtë ligj themelohet Inspektorati i Punës si trup Ekzekutiv i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Inspektorati i Punës mbikëqyrë zbatimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore ne lëmin e punës në mënyrë gjithë përfshirëse duke përfshinë marrëdhëniet e punës, sigurinë në punë, mbrojtjen e shëndetit të punësuarve dhe ambientit të punës"; 3. Ligjit për Siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të Punësuarve dhe Ambientit të Punës, si dhe dispozitave tjera të aplikueshme nga fusha e punësimit dhe mbrojtjes në punë", dhe ka ardhur në përfundimin se Inspektorati i Punës është institucioni përgjegjës i cili mbikëqyrë zbatimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore ne lëmin e punës në mënyrë gjithë përfshirëse duke përfshirë sigurinë në punë, mbrojtjen e shëndetit të punësuarve dhe ambientit të punës.

Meqenëse me dispozitat e ligjit material që rregullon marrëdhënien e punës në shërbimin civil, gjegjësisht me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik nuk trajtohet materia që ka për synim përmirësimin e kushteve të punës, mbrojtjen e shëndetit të punëtorëve, përmirësimin e ambientit të punës, mbrojtjen fizike dhe psikike të punësuarëve dhe të tjerëve që marrin pjesë në procesin e punë, andaj në mbështetje të nenit 21 paragrafi 1 dhe të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "1. Kompetenca lëndore e organit publik përcaktohet me ligj. 2. Nëse kompetenca lëndore për një çështje të caktuar nuk përcaktohet shprehimisht nga ligji apo është e pamundur të përcaktohet sipas natyrës të çështjes, organi publik i ngarkuar me mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit përkatës material, do të ketë kompetencën lëndore mbi atë çështje", ndërlidhur me nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit konstaton se Këshilli nuk ka kompetencë lëndore për të trajtuar ankesën e ankueseve të datës 01.03.2023, pasi që për çështje të natyrës së tillë sipas dispozitave të Ligji Nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës në Kosovë dhe Ligjit Nr. 03/L-017 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës Nr. 2002/9, organi kompetentë është Inspektorati i punës.

Marr parasysh konstatimin si me lartë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka kompetencë lëndore për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr. 444/2023 të datës 01.03.2023, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 75 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/031 për



Procedurën e Përgjithshme Administrative vendosi që lënda t'i dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent, në këtë rast Inspektoratit të Punës.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyres për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.444/2023

**Flakron GASHI**

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



### Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Inspektoratit të Punës;
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë,
- Arkivit të KPMSHCK- së;

